

6 patriotë të fotografuar më 1914: Ceno Sharra, Hil Mosi, Mustafa Qulli, Kel Marubi(në këmbë), Hysni Curri dhe Duro Guri(ulur).

I ati Marku e kishte rritur e edukuar me adhurim të gjuhës shqipe dhe atdheut. Sa kishte marrë njohuri fillestare dhe të mesme në Shkodrën e lindjes, interesat për diturl i zgjeroi në qytetin Klagenfurt të Austrisë. Edhe atje takon njerëz të shqiptarizmës dhe të dëshmive krijuese, të cilat veç sa ia forcuan bindjet, veç sa ia mprehën synimin, veç sa ia kultivuan shijen krijuese artistike. I ra hise të merrte pjesë në Kongresin historik të Manastirit, në Kongresin e Lushnjës, në Kryengritjen e Malësisë së Madhe, të jetë anëtar i Komisisë Letrare, të jetë përfaqësues i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, të zgjedhet deputet i Korçës, deri në fund të ushtrojë edhe ministër i arsimit. Ana tjetër e aktivitetit të tij ishin botimet e gazetave: në Stamboll "Shqiptari", në Klagenfurt "Kalendari Dija", në Shkodër gazetën "Shqypnija e re", në Korçë, shoqërinë "Gegënija". Pasuri të mëdha këto të jetës kreative të një njeriu, si dhe përgjegjësi kombëtare të dy kaheve për një qëllim.

Hil Mosi kishte botuar edhe dy vëllime poetike, që ishin të ndara në bazë të motiveve, në bazë të të cilave edhe i titullon ato. "Zan'i Atdheut" është vëllimi i vitit 1915, botuar në Trieste, dhe "Lotët e dashtnis" është vëllimi i vitit 1916, i botuar në Shkodër.

Poezia patriotike e Mosit është frymëzuar në bazë të kohëve të lavdishme të historisë sonë dhe të personaliteteve të pakontestueshme të saj. Ky ishte stil i të gjithë krijuesve, që poezinë e kishin më shumë hobi, në mos duke krijuar kishin mendjen te efekti propagandistik i saj. Përpos Lekës e Kastriotit, aty u vargërohet edhe Hajredin Tremishtit, Spiro Bellkamenit, Bajram Currit, Isa Boletinit e ndonjë tjetri. Kërkesat e atdhetarisë Mosi i përcakton me kushte, si *"Atdhetar me qen'i mir',/ Duhet zemra t'jet' e dlir',/ Jo e ndyt me fanatizëm."*, pra për Atdheun duhet menduar përherë, thotë ai.

Ekskluzivisht për Kosovën, Hil Mosi kishte shkruar dy poezi "Kosova në luftë", më 1910, dhe po atë vit, por në dhjetor, "Isa Buletini", që të dyja kur ishte në Stamboll. Trimërinë e kosovarëve ndaj turqve poeti e sheh të lidhur me Shqipërinë, sikur nuk mund ta shohë këtë ndarje trungu. *"N'kamb asht çu e rrebt'Kosova? E ban luftën ball për ball"*, krenohet ai, i cili veprim është forcë i krahut shqiptar. Si edhe kolegu i vet, shkodrani Risto Siliqi, vjershën e ndërtojnë në mbështetje të fakteve historike, të cilat nuk bëhen përpjekje të "fshihen" sado pak. Mahnitja e heroizmit të njeriut të ri apo edhe atij që është prijësi popullor, si Isa Boletini.

Se kjo sakrificë që bëhet do të shpaguhet patjetër, ai shprehet kur thotë:

E n'Prishtin', atje pik' s'parit
Krisi topi me duhi,
Atje gjaku i Shqyptarit
Ra në tok' me bi përsëri.

Pastaj përjetësohen Kaçaniku e Cërnaleva, ku turqit thyhen turpshëm me ushtri të panumërt, e kosovarët, me forcën e sakrificës e të rezistencës, krijojnë papërsëritshmërinë e këtyre çasteve historike. Forca e madhe morale mbështetet dhe arsyetohet më qëllimin e lartë, që i është përcaktuar vetes, si dhe me trashëgiminë luftarake të prijësit popullor. Isa Boletini, po e zëmë, nuk ndalon me gjithë tragjikat familjare *"kur djemt' t'përgjakun para t'ranë, / S'u trembe, por si trim në zjerm u fute"*.

Poezia e krijuar në frymën e poezisë popullore mori po atë karakter dhe u bë këngë, duke humbur autorësinë dhe duke u shkrirë në krijimtarinë gojore.

Hil Mosi, që krijonte vetëm kur diçka nuk mund ta shprehte në format e tjera që edhe i ishte dhënë mundësia (për çka e cekëm më herët), vargëzoënte, duke i ruajtur dy gjëra: saktësinë e ngjarjes dhe anën formale të rimimit për melodizëm. Kjo edhe e bënte deklarative vargun, duke e zbehur artistikën si vlerë të poezisë. Hil Mosi nuk bën përjashtim nga grupi i krijuesve minorë dhe me sanime jetësore tjetërfare. Kohët, si parësore, dhe përcaktimet jetësore të krijuesit, si dytësore, bëjnë që krijimtaria të jetë ashtu siç edhe është këtu.

Krijuesi ynë gjithmonë u gjend në këto dy përcaktime të njëzuara: artin s'e çmonte pa atdhetarinë e potencuar fort, atdhetaria i bëhej është më e kapshme po të latrarizohej. Këto dy raporte kundërshtoheshin gjer në mes.•

Sinan GASHI